

Kuadri rregullator i Bashkimit European për pronësinë përfituese

Shkurt 2026



RRETH KËSAJ SERIE DOKUMENTESH SHPJEGUESE

Ky dokument shpjegues është pjesë e një serie vlerësimesh tematike legislative të përgatitura nga [Transparency International EU](#). Seria ofron një përmbledhje mbi zhvillimet kryesore të prezantuara nga paketa e Bashkimit Europian kundër pastrimit të parave (AML) e vitit 2024 dhe rëndësinë e tyre për procesin në vijim të përafrimit të Shqipërisë me acquis të Bashkimit Europian, veçanërisht në kuadër të Kapitujve 23 dhe 24.

Dokumentet publikohen të përkthyer në gjuhën shqipe për të mbështetur përfshirjen e informuar të organizatave të shoqërisë civile, institucioneve akademike, gazetarëve investigativë dhe aktorëve të tjerë në proceset e konsultimit që lidhen me reformat legislative dhe institucionale në fushën e transparencës dhe integritetit financiar.

Ky dokument bazohet në përkthimin e versionit në gjuhën angleze të “EU AML Legislative Assessment”. Në rast mospërputhjes, versioni origjinal në gjuhën angleze prevalon.

Ky dokument është përgatitur nga Transparency International EU me kërkesë të BIRN Albania në kuadër të projektit *“Follow the Money: Strengthening Albania’s Anti-Money Laundering Initiatives”*, me mbështetjen e FCDO përmes Ambasadës Britanike në Tiranë. Gjetjet e këtij dokumenti janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Ambasadës Britanike në Tiranë.

PËRMBLEDHJE E KUADRIT RREGULLATOR TË BE¹-SË PËR PRONËSINË PËRFITUESE

Regjistrat e pronësisë përfituese (BO²) janë një mjet kyç në luftën kundër pastrimit të parave dhe një gur themeli i transparencës financiare. Duke zbuluar personin ose personat fizikë që në fund zotërojnë ose kontrollojnë personat juridikë dhe strukturat juridike, regjistrat e pronarit të fundit përfitues (BO) ndihmojnë në parandalimin e keqpërdorimit të strukturave korporative për të fshehur produkte të veprës penale, për t'iu shmangur sanksioneve ose për të fshehur konfliktet e interesit. Pas miratimit të [Direktivës së Katërt të Parandalimit të Pastrimit të Parave](#) (AMLD4³) në maj 2015, Shteteve Anëtare iu kërkua të krijonin regjistra të pronësisë përfituese që përmbanin informacion bazë mbi pronarët përfitues të strukturave korporative, trusteve, fondacioneve dhe entiteteve të ngjashme. Megjithatë, Direktiva parashikonte gjithashtu se anëtarët e publikut të gjerë mund të kishin akses në regjistrat BO vetëm nëse arrinin të provonin që kishin një “interes legjitim”. Në vitin 2018, [Direktiva e Pestë kundër Pastrimit të Parave](#) (AMLD5⁴) e zgjeroi këtë akses te publiku i gjerë, duke hequr kërkesën për “interes legjitim”. Megjithatë, katër vjet më vonë, në nëntor 2022, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJEDBE) vendosi se aksesi i pakufizuar i çdo anëtari të publikut në regjistrat e pronësisë përfituese ishte i [pavlefshëm](#), pasi binte ndesh me nenin 7 (e drejta për respektimin e jetës private) dhe nenin 8 (mbrojtja e të dhënave) të [Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian](#), si dhe me nenin 5 të [Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave](#) (GDPR)⁵.

Në maj 2024, BE-ja miratoi një kuadër të ri ligjor për pronësinë përfituese si pjesë e paketës së saj më të fundit kundër pastrimit të parave. [Rregullorja AML](#), e njohur si “kuadri unik rregullator” (single rulebook), forcon transparencën e pronësisë përfituese duke përcaktuar qartë cilët konsiderohen pronarë përfitues, duke kërkuar vlerësimin e pronësisë dhe kontrollit, si dhe duke kërkuar që personat juridikë të marrin, ruajnë dhe përditësojnë rregullisht informacionin mbi pronarët përfitues. Ajo gjithashtu forcon detyrimet për ushtrimin e vigjilencës së duhur ndaj klientit për

¹ BE - Bashkimi Evropian

² BO - Nga anglishtja, akronim për *Beneficial Ownership*

³ AMLD4 - Nga anglishtja, akronim për *The fourth Anti-Money Laundering Directive*

⁴ AMLD5 - Nga anglishtja, akronim për *The fifth Anti-Money Laundering Directive*

⁵ GDPR - Nga anglishtja, akronim për *General Data Protection Regulation*

institucionet financiare dhe subjektet e tjera raportuese, përfshirë verifikimin e pronarëve përfitues, kontrollin ndaj sanksioneve dhe ushtrimin e vigjilencës së shtuar në situata me risk të lartë, duke mbyllur kështu hapësirat e mëparshme që lejonin keqpërdorimin e strukturave korporative për qëllime të paligjshme. [Direktiva e Gjashtë e AML-së](#) (AMLD6⁶) plotëson Rregulloren AML duke përcaktuar rregulla të detajuara mbi krijimin, funksionimin dhe aksesin në regjistrat qendrorë të pronësisë përfituese. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që informacioni mbi pronarin përfitues të mbahet në një regjistër qendror në format të lexueshëm nga sistemi kompjuterik dhe që të ekzistojnë mekanizma për të garantuar se të dhënat janë të mjaftueshme, të sakta dhe të përditësuara. Edhe pse Direktiva rikthen kërkesën për “interes legjitim”, kuadri AML i BE-së i vitit 2024, në tërësi, forcon transparencën e pronësisë përfituese. Ai harmonizon rregullat kryesore, forcon detyrimet e raportimit dhe verifikimit dhe përmirëson ndërlidhjen ndërkufitare midis regjistrave.

⁶ AMLD6 - Nga anglishtja, akronim për *The sixth Anti-Money Laundering Directive*

RREGULLORJA AML, “KUADRI UNIK RREGULLATOR”

TEKSTI LEGJISLATIV

Rregullorja (BE) 2024/1624 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 31 maj 2024, për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

DISPOZITAT	SHPJEGIMI
Objekti Neni 1	
<p>Kjo Rregullore përcakton rregulla lidhur me:</p> <p>(a) masat që duhen zbatuar nga subjektet raportuese për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;</p> <p>(b) kërkesat për transparencën e pronësisë përfituese për personat juridikë, trustet e posaçme dhe strukturat juridike të ngjashme;</p> <p>(c) masat për të kufizuar keqpërdorimin e instrumenteve anonime.</p>	//

<p>Përkufizime</p> <p>Neni 2</p>	
<p>(...)</p> <p>28) “pronar përfitues” do të thotë çdo person fizik që në fund zotëron ose kontrollon një person juridik ose një trust apo strukturë juridike të ngjashme;</p>	<p>//</p>
<p>Fusha e politikave, procedurave dhe kontrolleve të brendshme</p> <p>Neni 9</p>	
<p>1) Subjektet raportuese duhet të kenë politika, procedura dhe kontrolle të brendshme për të siguruar përputhshmërinë me këtë Rregullore (...)</p> <p>2) Politikat, procedurat dhe kontrollet e përmendura në paragrafin 1 përfshijnë:</p> <p>(...)</p> <p>(iii) ushtrimin e vigjilencës së duhur ndaj klientit për zbatimin e Kreut III të kësaj Rregulloreje, përfshirë procedurat për të përcaktuar nëse klienti, pronari përfitues, ose personi në emër të të cilit apo në dobi të të cilit kryhet një transaksion ose veprimtari, është person i ekspozuar politikisht ose anëtar i familjes apo person i njohur si bashkëpunëtor i ngushtë;</p>	<p>//</p>

Masat e ushtrimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit

Neni 20

1) Me qëllim ushtrimin e vigjilencës së duhur ndaj klientit, **subjektet raportuese** duhet të zbatojnë të gjitha masat e mëposhtme:

(...)

(b) identifikimin e pronarëve përfitues dhe marrjen e masave të arsyeshme **për të verifikuar identitetin e tyre**, të tilla që subjekti raportues të bindet se e di kush është pronari përfitues dhe **se e kupton strukturën e pronësisë dhe kontrollit të klientit**;

(...)

(d) të verifikojë nëse klienti ose pronarët përfitues janë **subjekt i sanksioneve financiare** në fuqi (...);

(...)

(g) të përcaktojë nëse klienti, pronari përfitues i klientit dhe, kur është e zbatueshme, personi në emër të të cilit ose në dobi të të cilit kryhet një transaksion apo veprimtari, është **person i ekspozuar politikisht, anëtar i familjes ose person i njohur si bashkëpunëtor i ngushtë**;

Subjektet raportuese duhet të identifikojnë dhe verifikojnë pronarin përfitues, të kuptojnë strukturën e pronësisë dhe kontrollit, si dhe të sigurohen që as klienti dhe as pronari përfitues të mos jenë të sanksionuar.

Ato duhet gjithashtu të përcaktojnë nëse pronari përfitues (ose personat e lidhur me të) është person i ekspozuar politikisht (PEP), gjë që duhet të shoqërohet me ushtrimin e vigjilencës së zgjeruar, kur është e nevojshme.

Identifikimi dhe verifikimi i identitetit të klientëve dhe pronarëve përfitues

Neni 22

2) Me qëllim **identifikimin e pronarit përfitues të një personi juridik ose të një strukture juridike**, subjektet raportuese duhet të mbledhin informacionin e përmendur në nenin 62(1), nënparagrafi i dytë, pika (a).

Pasi janë shteruar të gjitha mjetet e mundshme të identifikimit, **nuk identifikohet asnjë person fizik si pronar përfitues**, ose kur ka dyshime se personat e identifikuar nuk janë pronarët përfitues, subjektet raportuese duhet të evidentojnë faktin se nuk u identifikua asnjë pronar i fundëm përfitues dhe duhet të identifikojnë të gjithë personat fizikë që mbajnë pozicionet e drejtuesve të lartë ekzekutivë në personin juridik, si dhe të verifikojnë identitetin e tyre.

Kur kryerja e verifikimit të identitetit të përmendur në nënparagrafin e dytë mund ta paralajmërojë klientin se subjekti raportues ka dyshime lidhur me pronësinë përfituese të personit juridik, subjekti raportues duhet të heqë dorë nga identifikimi i drejtuesve të lartë ekzekutivë dhe në vend të kësaj, **të dokumentojë hapat e ndërmarrë për të përcaktuar identitetin e pronarëve të fundëm përfitues dhe të drejtuesve të lartë ekzekutivë**. Subjektet raportuese duhet të ruajnë evidenca për veprimet e ndërmarra, si dhe për vështirësitë e hasura gjatë procesit të identifikimit, të cilat çuan në identifikimin e një drejtuesi të lartë ekzekutiv në vend të pronarit të fundit përfitues.

(...)

Përveç mjeteve të verifikimit të përcaktuara në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi, subjektet raportuese **duhet të verifikojnë informacionin mbi pronarët përfitues duke konsultuar regjistrat qendrorë**.

Subjektet raportuese duhet të identifikojnë dhe të marrin masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e pronarit përfitues, duke përdorur dokumente të besueshme dhe burime të sigurta informacioni.

<p>Koha e verifikimit të identitetit të klientit dhe të pronarit përfitues</p> <p>Neni 23</p>	
<p>1) Verifikimi i identitetit të klientit, të pronarit përfitues dhe të çdo personi sipas nenit 20(1), pikat (h) dhe (i), duhet të kryhet përpara vendosjes së një marrëdhënieje biznesi ose kryerjes së një transaksioni të rastësishëm (...)</p> <p>2) Në përjashtim nga rregulli i paragrafit 1, verifikimi i identitetit të klientit dhe të pronarit përfitues mund të plotësohet gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit, nëse kjo është e nevojshme për të mos ndërprerë zhvillimin normal të veprimtarisë dhe kur ekziston risk i ulët i pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit. Në këto raste, këto procedura duhet të përfundojnë sa më shpejt që të jetë e mundur pas kontaktit fillestar.</p>	<p>//</p>
<p>Raportimi i mospërputhjeve me informacionin që përmbajnë regjistrat e pronësisë përfituese</p> <p>Neni 24</p>	
<p>(...)</p> <p>Kur një subjekt raportues konstaton se informacioni mbi pronësinë përfituese në regjistrin qendror është i pasaktë, ai fton klientin të paraqesë informacionin e saktë në regjistrin qendror sipas neneve 63, 64 dhe 67, pa vonesë dhe, në çdo rast, brenda 14 ditëve kalendarike.</p>	<p>//</p>

<p>Identifikimi i vendeve të treta që paraqesin një kërcënim specifik dhe serioz për sistemin financiar të Bashkimit European</p> <p>Neni 31</p>	<p>//</p>
<p>1) Komisioni autorizohet të miratojë akte të deleguara, në përputhje me nenin 85, për të plotësuar këtë Rregullore përmes identifikimit të vendeve të treta ku, në raste të jashtëzakonshme, vlerësohet e domosdoshme zbutja e një kërcënimi specifik dhe serioz që i kanoset sistemit financiar të Bashkimit European dhe funksionimit të rregullt të tregut të brendshëm nga këto vende (...)</p> <p>2) Kur të hartohen aktet e deleguara të përmendura në paragrafin 1, Komisioni duhet të marrë në konsideratë, në veçanti, kriteret e mëposhtme:</p> <p>(...)</p> <p>(v) disponueshmërinë e informacionit të saktë dhe në kohë mbi pronësinë përfituese të personave juridikë dhe strukturave juridike për autoritetet kompetente.</p>	
<p>Fusha e zbatimit të masave të vigjilencës së zgjeruar</p> <p>Neni 34(4)</p>	<p>//</p>
<p>(...) subjektet raportuese duhet të zbatojnë masa të vigjilencës së zgjeruar, proporcionale me risqet më të larta të identifikuara, të cilat mund të përfshijnë masat e mëposhtme:</p> <p>(a) marrjen e informacionit shtesë për klientin dhe pronarët përfitues;</p> <p>(...)</p> <p>(c) marrjen e informacionit shtesë mbi burimin e fondeve dhe burimin e pasurisë së klientit dhe të pronarëve përfitues.</p>	

Identifikimi i pronarëve përfitues për personat juridikë

Neni 51

Pronarët përfitues të personave juridikë janë personat fizikë që:

(a) kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes pronësie në personin juridik; ose

(b) kontrollojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, subjektin juridik ose personin tjetër juridik, përmes interesit në pronësi ose me mjete të tjera.

Kontrolli me mjete të tjera (...) duhet të **identifikohet në mënyrë të pavarur dhe paralelisht me ekzistencën e një interesi pronësie** ose të kontrollit nëpërmjet interesit në pronësi.

Kreu IV lidhet me transparencën e pronësisë përfituese.

Përcaktimi i ekzistencës së një interesi pronësie ose i kontrollit nëpërmjet interesit në pronësi është i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm, dhe nuk përjashton nevojën për kontrole të mëtejshme për të përcaktuar pronarët përfitues. Vlerësimi nëse një person fizik ushtron kontroll me mjete të tjera nuk është një analizë që duhet të kryhet vetëm kur nuk është e mundur të përcaktohet një interes pronësie në personin juridik. Të dyja vlerësimet, pra ekzistenca e një interesi pronësie ose kontrollit nëpërmjet interesit në pronësi dhe kontrolli me mjete të tjera, duhet të kryhen paralelisht.

Shembull i praktikës së mirë

Letonia konsiderohet si një shembull i praktikës së mirë lidhur me pronësinë përfituese. Ajo integron informacionin mbi pronësinë përfituese të personave juridikë dhe marrëveshjeve ligjore në [regjistrin e saj tregtar](#), i cili përfshin të dhëna mbi anëtarët e bordeve, aktet e themelimit dhe pasqyrat financiare vjetore. Çfarë është më e rëndësishmja, ky sistem ofron informacion të detajuar mbi shoqëritë, duke shfaqur zinxhirin e plotë të pronësisë së bashku me elementët kryesore identifikuese, si datëlindja dhe numri i pasaportës ose i letërnjoftimit, gjë që mundëson identifikimin e qartë dhe të padiskutueshëm të pronarëve përfitues.

Pronësia përfituese nëpërmjet interesit në pronësi

Neni 52

1) Për qëllime të nenit 51, paragrafi i parë, pika (a), "**interes pronësie në personin juridik**" nënkupton pronësinë e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të 25 % ose më shumë të aksioneve ose të të drejtave të votës, ose të një interesi tjetër pronësie në personin juridik, përfshirë të drejtat për një pjesë të fitimeve, burimeve të tjera të brendshme ose bilancit të likuidimit(...)

Për qëllime të vlerësimit nëse ekziston një interes pronësie në personin juridik, **merren në konsideratë të gjitha zotërimet e aksioneve në çdo nivel të strukturës së pronësisë.**

(...)

Deri më 10 korrik 2029, Komisioni do të vlerësojë nëse risqet që lidhen me këto kategori personash juridikë janë të rëndësishme për tregun e brendshëm dhe, nëse arrin në përfundimin **se një prag më i ulët është i përshtatshëm për të zbutur këto risqe, do të miratojë akte të deleguara** në përputhje me nenin 85 për të ndryshuar këtë Rregullore (...).

Zotërimi i 25 % ose më shumë të aksioneve, të të drejtave të votës ose i një interesi tjetër pronësie, si rregull, përcakton pronësinë përfituese të një subjekti korporativ. Interesi në pronësi duhet të përfshijë si të drejtat e kontrollit, ashtu edhe të drejtat që janë të rëndësishme në aspektin e përfitimit ekonomik, si e drejta për një pjesë të fitimeve ose të burimeve të tjera të brendshme, apo të bilancit të likuidimit.

Pronësia përfituese nëpërmjet kontrollit

Neni 53

1) Kontrolli mbi një entitet korporativ ose mbi një person tjetër juridik ushtrohet përmes interesit në pronësi ose me mjete të tjera.

(...)

(a) **“kontroll i personit juridik”** do të thotë mundësia për të ushtruar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndikim të rëndësishëm dhe për të imponuar vendime përkatëse brenda personit juridik;

(b) **“kontroll i tërthortë i një personi juridik”** do të thotë kontrolli i personave juridikë ndërmjetës në strukturën e pronësisë ose në zinxhirë të ndryshëm të strukturës së pronësisë, kur kontrolli i drejtpërdrejtë identifikohet në çdo nivel të strukturës;

(c) **“kontroll nëpërmjet interesit në pronësi të entitetit korporativ”** do të thotë pronësia e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e 50 % plus një të aksioneve, të të drejtave të votës ose të një interesi tjetër pronësie në personin juridik.

Kontrolli duhet të kuptohet si aftësia reale për të imponuar vullnetin e dikujt në vendimmarrjen e entitetit korporativ për çështje thelbësore. Mjeti i zakonshëm i kontrollit është shumica e të drejtave të votës. Pozita e pronarit përfitues mund të përcaktohet edhe nëpërmjet kontrollit me mjete të tjera, pa pasur interes të rëndësishëm, ose asnjë interes, në pronësi. Për këtë arsye, për të identifikuar të gjithë individët që janë pronarë përfitues të një personi juridik, kontrolli duhet të identifikohet në mënyrë të pavarur nga interesi në pronësi.

Bashkëekzistenca e interesit në pronësi dhe e kontrollit në strukturën e pronësisë

Neni 54

Kur entitetet korporative zotërohen **përmes një strukture pronësie shumë-shtresore** dhe, në një ose më shumë zinxhirë të kësaj strukture, **interesi në pronësi dhe kontrolli bashkëekzistojnë** të lidhura në shtresa të ndryshme të zinxhirit, pronarët përfitues janë:

(a) personat fizikë që kontrollojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet interesit në pronësi ose me mjete të tjera, personat juridikë që kanë një interes të drejtpërdrejtë pronësie në personin juridik, qoftë individualisht ose kumulativisht;

(b) personat fizikë që, qoftë individualisht ose kumulativisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi, kanë një interes pronësie në personin juridik që kontrollon, nëpërmjet interesit në pronësi ose me mjete të tjera, personin juridik, drejtpërdrejt ose tërthorazi.

//

Identifikimi i pronarëve përfitues për persona juridikë të ngjashëm me trustet e posaçme

Neni 57

1) Në rastin e **personave juridikë** të ndryshëm nga ata të përmendur në nenin 51, **të ngjashëm me trustet e posaçme, si fondacionet**, pronarët përfitues janë të gjithë personat fizikë të mëposhtëm:

- (a) themeluesit;
 - (b) anëtarët e organit drejtues në funksionin e tij menaxhues;
 - (c) anëtarët e organit drejtues në funksionin e tij mbikëqyrës;
 - (d) përfituesit, përveç rasteve kur zbatohet neni 59;
 - (e) çdo person tjetër fizik që kontrollon drejtpërdrejt ose tërthorazi personin juridik.
- (...)

//

<p>Identifikimi i pronarëve përfitues për trustet e posaçme dhe strukturat juridike të ngjashme</p> <p>Neni 58</p>	
<p>1) Pronarët përfitues të trusteve të posaçme janë të gjithë personat fizikë të mëposhtëm:</p> <p>(a) themeluesit;</p> <p>(b) kujdestarët (trustees);</p> <p>(c) mbrojtësit, nëse ka;</p> <p>(d) përfituesit, përveç rasteve kur zbatohet neni 59 ose 60; dhe</p> <p>(e) çdo person tjetër fizik që ushtron kontroll përfundimtar mbi trustin e posaçëm nëpërmjet pronësisë së drejtpërdrejtë ose të tërthortë apo me mjete të tjera, përfshirë përmes një zinxhiri kontrolli ose pronësie.</p> <p>(...)</p>	<p>//</p>
<p>Identifikimi i personave që mund të përzgjidhen si përfitues dhe i përfituesve në mungesë në një trust</p> <p>Neni 60</p>	
<p>Në rastin e trusteve diskrecionale, kur përfituesit ende nuk janë përzgjedhur, duhet të identifikohen objektet e një pushteti diskrecional⁷ dhe përfituesit në mungesë⁸.</p> <p>Përfituesit e përzgjedhur midis objekteve të pushtetit diskrecionar duhet të bëhen pronarë përfitues sapo përzgjidhen. Përfituesit në mungesë duhet të bëhen pronarë përfitues kur kujdestarët (trustees) nuk ushtrojnë diskrecionin e tyre.</p>	<p>//</p>

⁷ Objektet e pushtetit diskrecionar-personat ose kategoria e personave që mund të përzgjidhen nga kujdestarët si përfitues.

⁸ Përfituesit në mungesë - personat që përfitojnë nëse kujdestarët nuk e ushtrojnë diskrecionin e tyre

<p>Identifikimi i pronarëve përfitues të sipërmarrjeve të investimeve kolektive</p> <p>Neni 61</p>	
<p>Me përjashtim nga neni 51, paragrafi i parë dhe neni 58(1), pronarët përfitues të sipërmarrjeve të investimeve kolektive duhet të jenë personat fizikë që përmbushin një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme:</p> <p>(a) zotërojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi 25 % ose më shumë të njësive të mbajtura në sipërmarrjen e investimit kolektiv;</p> <p>(b) kanë aftësinë të përcaktojnë ose të ndikojnë politikën e investimit të sipërmarrjes së investimit kolektiv; dhe</p> <p>(c) kontrollojnë veprimtarinë e sipërmarrjes së investimit kolektiv me mjete të tjera.</p>	<p>//</p>
<p>Informacioni mbi pronësinë përfituese</p> <p>Neni 62</p>	
<p>1) Personat juridikë dhe kujdestarët e trusteve të posaçme ose personat që mbajnë pozicione ekuivalente në struktura juridike të ngjashme duhet të sigurohen që informacioni mbi pronësinë përfituese që ata mbajnë, që u japin subjekteve raportuese në kuadër të procedurave të vigjilencës së duhur ndaj klientit në përputhje me Kreun III ose që paraqesin në regjistrat qendrorë, të jetë i mjaftueshëm, i saktë dhe i përditësuar.</p> <p>(...)</p>	<p>Të gjithë personat juridikë në Bashkimin Evropian duhet të marrin dhe të mbajnë informacion mbi pronësinë përfituese që është i mjaftueshëm, i saktë dhe i përditësuar. Ky informacion duhet të ruhet për 5 vjet dhe identiteti i personit përgjegjës për ruajtjen e tij duhet t'u raportohet regjistrave qendrorë. Kjo periudhë ruajtjeje është e barasvlefshme me periudhën e ruajtjes së informacionit të marrë nëpërmjet zbatimit të kërkesave AML/CFT, siç janë masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit.</p>

Detyrimet e personave juridikë

Neni 63

- 1) Të gjithë personat juridikë të krijuar në Bashkimin Europian **duhet të marrin dhe të mbajnë informacion mbi pronësinë përfituese që është i mjaftueshëm, i saktë dhe i përditësuar.** (...)
- 2) Një person juridik duhet të raportojë informacionin mbi pronësinë përfituese në regjistrin qendror pa vonesë pas krijimit të tij. **Çdo ndryshim në këtë informacion duhet të raportohet në regjistrin qendror pa vonesë dhe, në çdo rast, brenda 28 ditëve kalendarike.** Personi juridik duhet të verifikojë rregullisht se zotëron informacion të përditësuar mbi pronësinë e tij përfituese. **Së paku, një verifikim i tillë duhet të kryhet çdo vit,** qoftë si proces më vete, qoftë si pjesë e proceseve të tjera periodike, siç është paraqitja e pasqyrave financiare. (...)
- 3) Kur, pas shterimit të të gjitha mjeteve të mundshme të identifikimit sipas neneve 51 deri 57, **nuk identifikohet asnjë person si pronar përfitues,** ose kur personi juridik ka pasiguri të konsiderueshme dhe të arsyetuara se personat e identifikuar janë pronarët përfitues, **personi juridik mban evidenca për veprimet e ndërmarra për të identifikuar pronarët e tij përfitues.**

Për të siguruar që informacioni mbi pronësinë përfituese të jetë i përditësuar, personi juridik duhet ta përditësojë atë menjëherë pas çdo ndryshimi dhe duhet ta verifikojë periodikisht, për shembull në momentin e paraqitjes së pasqyrave financiare, ose me rastin e ndërveprimeve të tjera të përsëritura me autoritetet publike.

Personat juridikë të huaj dhe strukturat juridike të huaja

Neni 67

1) Personat juridikë të krijuar jashtë Bashkimit Europian dhe kujdestarët e trusteve të posaçme, ose personat që mbajnë një pozicion ekuivalent në një strukturë juridike të ngjashme, e cila administrohet jashtë Bashkimit Europian ose ku kujdestari apo personi në pozitë ekuivalente banon ose është i vendosur jashtë BE-së, duhet të paraqesin informacionin mbi pronësinë përfituese, sipas nenit 62, në regjistrin qendror të Shtetit Anëtar ku ata:

- (a) hyjnë në një marrëdhënie biznesi me një subjekt raportues;
- (b) blejnë pasuri të paluajtshme në Bashkimin Europian, drejtpërdrejt ose përmes ndërmjetësve;
- (c) blejnë, drejtpërdrejt ose përmes ndërmjetësve, (...) automjete motorike me vlerë të paktën 250,000 euro (...), mjete lundruese ose mjete ajrore me vlerë të paktën 7,500,000 euro;
- (d) u jepet një kontratë publike për mallra ose shërbime, ose një koncesion nga një autoritet kontraktues në Bashkimin Europian(...).

Kur një person juridik i krijuar jashtë Bashkimit Europian, ose një trust i posaçëm apo strukturë juridike e ngjashme e administruar jashtë BE-së, ose kujdestari apo personi në pozitë ekuivalente i së cilës banon ose është i vendosur jashtë BE-së, është gati të hyjë në një marrëdhënie biznesi me një subjekt raportues, regjistrimi i informacionit mbi pronësinë përfituese në regjistrin qendror të një Shteti Anëtar duhet të jetë parakusht për hyrjen në marrëdhënien e biznesit.

Shembull i praktikës së mirë

Gjermania dhe Letonia e kërkojnë tashmë këtë, ndërsa Shtetet e tjera Anëtare duhet t'i zbatojnë këto masa deri në korrik 2027.

Sanksionet

Neni 68

2) Deri më 10 korrik 2026, **Komisioni** duhet të miratojë **akte të deleguara** në përputhje me nenin 85 për të plotësuar këtë Rregullore duke përcaktuar:

- (a) kategoritë e shkeljeve që do të jenë subjekt i sanksioneve dhe personat përgjegjës për këto shkelje;
- (b) treguesit për klasifikimin e nivelit të rëndësisë së shkeljeve që i nënshtrohen sanksioneve;
- (c) kriteret që duhen marrë parasysh gjatë caktimit të nivelit të sanksioneve.

Për të siguruar një qasje të qëndrueshme në zbatimin e kërkesave mbi pronësinë përfituese në të gjithë tregun e brendshëm, **Komisioni autorizohet të miratojë akte të deleguara për të përcaktuar kategoritë e shkeljeve që do të jenë subjekt i sanksioneve dhe personat përgjegjës për këto shkelje**, si dhe treguesit për nivelin e rëndësisë dhe kriteret për përcaktimin e nivelit të sanksioneve.

DIREKTIVA E GJASHTË E AML-SË

TEKSTI LEGJISLATIV

Direktiva (BE) 2024/1640 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 31 maj 2024, mbi mekanizmat që duhet të vendosen nga Shtetet Anëtare për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit – AMLD6.

DISPOZITAT	SHPJEGIMI
Objekti Neni 1	
Kjo Direktivë përcakton rregulla lidhur me: (a) (...) (b) (...) (c) (...) (d) krijimin dhe aksesin në regjistrin mbi pronësinë përfituese (...);	//

Regjistrat qendrorë të pronësisë përfituese

Neni 10

1) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që informacioni **mbi pronësinë përfituese**, sipas nenit 62 të Rregullores (BE) 2024/1624, (...) të mbahet në një **regjistër qendror** në Shtetin Anëtar ku është krijuar personi juridik ose ku kujdestari i një trusti të posaçëm, apo personi që mban një pozicion ekuivalent në një strukturë juridike të ngjashme, është i vendosur ose banon, ose prej nga administrohet struktura juridike. **Kjo kërkesë nuk zbatohet për personat juridikë ose strukturat juridike të përmendura në nenin 65 të Rregullores (BE) 2024/1624** (shoqëri, letrat me vlerë të cilave tregtohen në një treg të rregulluar, dhe subjekte të së drejtës publike).

Informacioni që përmban regjistri qendror i pronësisë përfituese i përmendur në nënparagrafin e parë ("regjistri qendror") duhet të jetë i disponueshëm në **format të lexueshëm nga sistemi kompjuterik** dhe të mblidhet në përputhje me aktet zbatuese të përmendura në paragrafin 6.

2) Me përjashtim nga nënparagrafi i parë i paragrafit 1, Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që informacioni mbi pronësinë përfituese, sipas nenit 62 të Rregullores (BE) 2024/1624, **për personat juridikë të huaj dhe strukturat juridike të huaja**, sipas nenit 67 të asaj Rregulloreje, **të mbahet në një regjistër qendror** në Shtetin Anëtar në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 67 të asaj Rregulloreje. Shtetet Anëtare duhet të sigurohen gjithashtu që regjistri qendror të përmbajë treguesin se cila situatë e renditur në nenin 67(1) të Rregullores (BE) 2024/1624, ka shkaktuar regjistrimin e personit juridik të huaj ose të strukturës juridike të huaj.

3) (...)

4) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që **entitetet përgjegjëse për regjistrat qendrorë të kenë të drejtën të kërkojnë** nga personat juridikë, kujdestarët e çdo trusti të posaçëm dhe personat që mbajnë një pozitë ekuivalente në një strukturë juridike të ngjashme, si dhe nga pronarët e tyre ligjorë dhe përfitues, **çdo informacion të nevojshëm për identifikimin dhe verifikimin e pronarëve të tyre përfitues**, (...).

Regjistrat qendrorë të informacionit mbi pronësinë përfituese kanë një rol kyç kundër keqpërdorimit të personave juridikë dhe strukturave juridike. Për këtë arsye, Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që ky informacion (emri, mbiemri, vendi dhe data e plotë e lindjes etj.; shih nenin 62 të Rregullores) të mbahet në regjistra qendrorë të vendosur jashtë vetë entitetit, në përputhje të plotë me të drejtën e Bashkimit Europian.

Personat juridikë të huaj duhet gjithashtu të regjistrohen dhe informacioni duhet të jetë i disponueshëm **në format të lexueshëm nga sistemi kompjuterik**.

Autoritetet e regjistratit kanë të drejtë të kërkojnë informacionin e nevojshëm për të identifikuar dhe verifikuar pronarët përfitues dhe, nëse pronari përfitues nuk mund të identifikohet, regjistri duhet të përmbajë një deklaratë të arsyetuar.

Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që **informacioni të jetë i mjaftueshëm, i saktë dhe i përditësuar**.

Afate kryesore

- **10 korrik 2025:** Komisioni miraton aktet zbatuese që përcaktojnë formatin teknik të paraqitjes së informacionit (shih nenin 14 të AMLD6 më sipër) dhe kërkesat minimale për verifikim. → Transparency International [paraqiti komente](#) në konsultimin publik të Komisionit për "Anti-money laundering – formats for the submission of beneficial ownership information to central registers", *Feedback from Transparency International, në dhjetor 2025*.
- **10 korrik 2028:** Komisioni duhet të nxjerrë rekomandime mbi metodat e verifikimit dhe raportimin e mospërputhjeve.

5) Kur asnjë person nuk identifikohet si pronar përfitues sipas nenit 63(3) dhe nenit 64(6) të Rregullores (BE) 2024/1624, regjistri qendror duhet të përfshijë:

(a) **një deklaratë se nuk ka pronar përfitues** ose se pronarët përfitues nuk mund të përcaktohen, të shoqëruar me një justifikim përkatës sipas nenit 63(4)(a) dhe nenit 64(7)(a) të Rregullores (BE) 2024/1624;

(b) **të dhënat e të gjithë personave fizikë që mbajnë pozicionin e drejtuesve të lartë ekzekutivë** në personin juridik, ekuivalente me informacionin e kërkuar sipas nenit 62(1), nënparagrafi i dytë, pika (a), të Rregullores (BE) 2024/1624.

6) **Deri më 10 korrik 2025, Komisioni duhet të përcaktojë**, me anë të akteve zbatuese, **formatin për paraqitjen e informacionit mbi pronësinë përfituese (...)** duke përfshirë **një listë kontrolli të kërkesave minimale** për informacionin që duhet të shqyrtohet nga entiteti përgjegjës për regjistrin qendror.

7) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që **informacioni mbi pronësinë përfituese** i mbajtur në regjistrat **qendrorë të jetë i mjaftueshëm, i saktë dhe i përditësuar**, dhe të vendosin mekanizma për këtë qëllim.

(...)

Deri më 10 korrik 2028, Komisioni do të nxjerrë **rekomandime mbi metodat dhe procedurat që duhen përdorur nga entitetet përgjegjëse për regjistrat qendrorë për verifikimin e informacionit mbi pronësinë përfituese** dhe nga subjektet raportuese dhe autoritetet kompetente për identifikimin dhe raportimin e mospërputhjeve lidhur me informacionin mbi pronësinë përfituese.

8) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që **informacioni** i përmbajtur në regjistrat qendrorë të **përfshijë çdo ndryshim në pronësinë përfituese të personave juridikë** dhe strukturave juridike, si dhe të marrëveshjeve me persona të emëruar, pas regjistrimit të tyre të parë në regjistrin qendror.

Shembull i praktikës së mirë

Letonia spikat si shembull i praktikës së mirë sepse e përfshin informacionin mbi pronësinë përfituese të personave juridikë dhe strukturave juridike në regjistrin e saj tregtar.

Për më tepër, të dhënat e Letonisë mbi pronësinë përfituese, si edhe të dhënat mbi personat juridikë, janë të disponueshme publikisht. Të dhënat mbi personat juridikë ofrohen gjithashtu si sete të shkarkueshme të të dhënave të plota në Lituani dhe në Slloveni.

Vende të tjera që kanë krijuar regjistra qendrorë të pronësisë përfituese për personat juridikë dhe strukturat juridike përfshijnë Francën dhe Irlandën, duke treguar një angazhim më të gjerë në mbarë Europën për forcimin e kuadrit të transparencës së pronësisë përfituese.

Rregullat e përgjithshme lidhur me aksesin në regjistrat e pronësisë përfituese nga autoritetet kompetente, organet vetërregulluese dhe subjektet raportuese

Neni 11

- 1) Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë **që autoritetet kompetente të kenë akses të menjëhershëm, të pafiltruar, të drejtpërdrejtë dhe pa pagesë në informacionin** e mbajtur në regjistrat qendrorë të ndërlidhur, të përmendur në nenin 10, pa njoftuar personin juridik ose strukturën juridike përkatëse.
- 2) **Aksesi** i përmendur në paragrafin 1 **u jepet**: (a) autoriteteve kompetente, (b) organeve vetërregulluese, (c) autoriteteve tatimore, (d) autoriteteve kombëtare me përgjegjësi të caktuara për zbatimin e masave kufizuese të Bashkimit Europian, (e) AMLA-s, (f) EPPO⁹-së, (g) OLAF¹⁰-it, (h) Europol¹¹-it dhe Eurojust¹²-it.
(...)
- 4) Shtetet Anëtare mund të zgjedhin ta mbajnë informacionin mbi pronësinë përfituese të ruajtur në regjistrat e tyre qendrorë të disponueshëm për subjektet raportuese kundrejt pagesës së një tarife, e cila duhet të kufizohet deri në vlerën minimale rreptësisht të nevojshme për të mbuluar kostot e sigurimit të cilësisë së informacionit të mbajtur në regjistrat qendrorë dhe të vënies së tij në dispozicion. (...)
- 5) **Deri më 10 tetor 2026, Shtetet Anëtare duhet t'i njoftojnë Komisionit listën e autoriteteve kompetente** dhe të organeve vetërregulluese, si dhe kategoritë e subjekteve raportuese **të cilave u është dhënë akses në regjistrat qendrorë** dhe llojin e informacionit të disponueshëm për subjektet raportuese. (...)

NJIF-et, autoritetet e tjera kompetente dhe organet vetërregulluese duhet të kenë akses të menjëhershëm, të pafiltruar, të drejtpërdrejtë dhe pa pagesë në informacionin mbi pronësinë përfituese, për qëllime të parandalimit, zbulimit, hetimit dhe ndjekjes penale të pastrimit të parave, veprave penale bazë ose financimit të terrorizmit.

Subjektet raportuese duhet gjithashtu të kenë akses në regjistrat qendrorë kur ushtrojnë vigjilencën e duhur ndaj klientit. Shtetet Anëtare mund të zgjedhin ta kushtëzojnë aksesin e subjekteve raportuese me pagesën e një tarife. Megjithatë, këto tarifa duhet të kufizohen deri në vlerën minimale të nevojshme për të mbuluar kostot e sigurimit të cilësisë së informacionit të mbajtur në regjistrat qendrorë dhe të vënies së tij në dispozicion, dhe nuk duhet të cenojnë aksesin efektiv në informacionin mbi pronësinë përfituese.

Organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Europian që luajnë rol në kuadrin rregullator të AML/CFT të BE-së kanë gjithashtu akses në informacionin mbi pronësinë përfituese. Ky është rasti i Zyrës së Prokurorit Publik Europian (**EPPO**), por edhe i Zyrës Europiane Kundër Mashtrimit (**OLAF**) në ushtrimin e hetimeve të saj, si dhe i **Europol-it dhe Eurojust-it** kur mbështesin hetimet e autoriteteve kombëtare. Si autoritet mbikëqyrës, **AMLA-s** duhet t'i jepet akses në informacionin mbi pronësinë përfituese kur ushtron veprimtari mbikëqyrëse.

⁹ EPPO - Nga anglishtja, akronim për *the European Public Prosecutor's Office*

¹⁰ OLAF - Nga anglishtja, akronim për *the European Anti-Fraud Office*

¹¹ EUROPOL - Agjencia e Bashkimit Europian për Bashkëpunimin në Zbatimin e Ligjit

¹² EUROJUST - Agjencia e Bashkimit Europian për Bashkëpunimin në Drejtësinë Penale

Rregulla të posaçme të aksesit në regjistrat e pronësisë përfituese për personat me interes legjitim

Neni 12

1) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që çdo person fizik ose juridik që **mund të provojë një interes legjitim** për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave, veprave penale bazë ose financimit të terrorizmit, **të ketë akses në informacionin e mëposhtëm mbi pronarët përfitues** të personave juridikë dhe strukturave juridike, të mbajtur në regjistrat qendrorë të ndërlidhur (...), **pa njoftuar personin juridik ose strukturën juridike përkatëse:**

- (a) emrin e pronarit përfitues;
- (b) muajin dhe vitin e lindjes së pronarit përfitues;
- (c) vendin e banimit dhe shtetësinë ose shtetësitë e pronarit përfitues;
- (d) për pronarët përfitues të personave juridikë, natyrën dhe shtrirjen e interesit përfitues të mbajtur;
- (e) për pronarët përfitues të trusteve të posaçme ose strukturave juridike të ngjashme, natyrën e interesit përfitues.

Përveç informacionit të përmendur në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi, Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që çdo person fizik ose juridik (...) **të ketë gjithashtu akses në informacionin historik mbi pronësinë përfituese të personit juridik** ose strukturës juridike, përfshirë personat juridikë ose strukturat juridike që janë shpërbërë ose kanë pushuar së ekzistuari **gjatë 5 viteve** të mëparshme, si dhe në një përshkrim të strukturës së kontrollit ose pronësisë. Aksesit sipas këtij paragrafi jepet me **mjete elektronike**. Megjithatë, Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që personat fizikë dhe juridikë që mund të provojnë interes legjitim të jenë në gjendje të kenë akses në informacion edhe në **formate të tjera**, nëse nuk janë në gjendje të përdorin mjetet elektronike.

2) (...)

3) (...)

Vendimi i Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në vitin 2022: nga AMLD5 te AMLD6

Në vitin 2022, [Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian](#) shpalli të pavlefshme dispozitën e Direktivës së Pestë AML, e cila jepte akses të pakufizuar në regjistrat e pronësisë përfituese, me arsyetimin se ajo ndërhynte në mënyrë joproportionale në të drejtat për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave sipas Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së.

Neni 12 i AMLD6 prezanton një prezumim të interesit legjitim. **Organizatave e shoqërisë civile, akademikët dhe gazetarët investigativë**, që punojnë për parandalimin e pastrimit të parave, duhet të konsiderohen se **kanë interes legjitim** për akses në informacionin mbi pronësinë përfituese, i cili është me rëndësi jetike për ushtrimin e funksioneve të tyre dhe për mbikëqyrjen publike.

Informacioni i pronarit përfitues duhet të mbetet i aksesueshëm përmes regjistrave qendrorë dhe sistemit të tyre të ndërlidhjes për **të paktën 5 vjet** pas shpërbërjes së personit juridik ose pas pushimit së ekzistuari të strukturës juridike.

Moszbulimi i regjistrave të aksesit: Megjithëse regjistrat qendrorë duhet të mbajnë evidencë se kush ka akses në informacionin e pronarit përfitues dhe mund t'ua zbulojnë këtë informacion pronarëve përfitues me kërkesë sipas GDPR, Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që ky zbulim të mos nxjerrë identitetin e gazetarëve ose të organizatave të shoqërisë civile që aksesojnë regjistrin për qëllime AML/CFT.

4) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që regjistrat qendrorë të mbajnë evidencë për personat që aksesojnë informacionin sipas këtij neni dhe të jenë në gjendje t'ua zbulojnë këto të dhëna pronarëve përfitues kur ata paraqesin një kërkesë sipas nenit 15(1)(c) të Rregullores (BE) 2016/679.

Megjithatë, Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që informacioni i dhënë nga regjistrat qendrorë të mos çojë në identifikimin e personit që konsulton regjistrin, kur këta persona janë:

(a) persona që veprojnë për qëllime gazetarie, raportimi ose çdo formë tjetër shprehjeje në media, të lidhura me parandalimin ose luftën kundër pastrimit të parave, veprave penale bazë ose financimit të terrorizmit;

(b) organizata të shoqërisë civile që janë të lidhura me parandalimin ose luftën kundër pastrimit të parave, veprave penale bazë ose financimit të terrorizmit.

Procedura për verifikimin dhe njohjen e ndërsjellë të interesit legjitim për akses në informacionin mbi pronësinë përfituese

Neni 13

1) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që entitetet përgjegjëse për regjistrat qendrorë të përmendur në nenin 10 të marrin masa **për të verifikuar ekzistencën e interesit legjitim** të përmendur në nenin 12, mbi bazën e dokumenteve, informacionit dhe të dhënave të marra nga personi fizik ose juridik që kërkon akses në regjistrin qendror (“aplikanti”) dhe, kur është e nevojshme, të informacionit që u vihet në dispozicion sipas nenit 12(3).

2) **Ekzistenca e një interesi legjitim** për akses në informacionin mbi pronësinë përfituese përcaktohet **duke marrë në konsideratë:**

(a) funksionin ose profesionin e aplikantit; dhe (b) me përjashtim të personave të përmendur në nenin 12(2), nënparagrafi i parë, pikat (a) dhe (b), lidhjen me personat juridikë ose strukturat juridike konkrete, informacioni i të cilave kërkohet.

3) Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që, kur aksesin në informacion kërkohet nga një person, interesi legjitim i të cilit për akses në informacionin mbi pronësinë përfituese, sipas njërës prej kategorive të përcaktuara në nenin 12(2), nënparagrafi i parë, **është verifikuar tashmë nga regjistri qendror i një Shteti tjetër Anëtar**, verifikimi i kushtit të përcaktuar në paragrafin 2, pika (a), të këtij neni konsiderohet i përmbushur me mbledhjen e provës së interesit legjitim të lëshuar nga regjistri qendror i atij Shteti tjetër Anëtar.

(...)

6) **Nga 10 nëntori 2026**, Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që entitetet përgjegjëse për regjistrat qendrorë të kryejnë verifikimin e përmendur në paragrafin 1 dhe t’i japin përgjigje aplikantit **brenda 12 ditëve pune**. (...) Afati për t’i dhënë përgjigje aplikantit **mund të zgjatet** me 12 ditë pune të tjera.

Kur entitetet përgjegjëse për regjistrat qendrorë vendosin të japin akses në informacionin mbi pronësinë përfituese, ato **lëshojnë një certifikatë aksesi me vlefshmëri 3-vjeçare**. Entitetet përgjegjëse për regjistrat qendrorë i përgjigjen çdo kërkesë të mëvonshme për akses në informacionin mbi pronësinë përfituese nga i njëjti person brenda 7 ditëve pune.

Entitetet që administrojnë regjistrat qendrorë duhet të verifikojnë ekzistencën e interesit legjitim **përpara se të japin akses në informacionin mbi pronësinë përfituese**. Verifikimi bazohet në dokumentet dhe informacionin e dhënë nga aplikanti dhe, kur është e nevojshme, në të dhëna të tjera të disponueshme.

Interesi legjitim vlerësohet duke marrë në konsideratë:

- funksionin ose profesionin e aplikantit; dhe
- lidhjen e tij me personin juridik ose strukturën juridike specifike në fjalë (me përjashtim të disa kategorive të paracaktuara sipas nenit 12).

Kur interesi legjitim i një personi është verifikuar tashmë në një Shtet tjetër Anëtar, kjo duhet **të njihet reciprokisht** dhe prova e lëshuar nga ai Shtet Anëtar përmbush kushtin përkatës.

Afatet kryesore

- **Nga 10 nëntori 2026**, autoritetet e regjistrat duhet të vendosin mbi kërkesat për akses brenda 12 ditëve pune (me mundësi zgjatjeje me 12 ditë të tjera).
- Nëse jepet akses, duhet të lëshohet një certifikatë me vlefshmëri 3-vjeçare.
- Kërkesat pasuese për akses nga i njëjti person duhet të marrin përgjigje brenda 7 ditëve pune.

Modelet dhe procedurat

Neni 14

1) **Komisioni duhet të përcaktojë, me anë të akteve zbatuese**, specifikimet teknike dhe procedurat e nevojshme për zbatimin nga regjistrat qendrorë, mbi bazën e interesit legjitim, të aksesit të parashikuar në nenin 10, duke përfshirë:

(a) **modele të standardizuara për kërkimin e aksesit** në regjistrin qendror dhe për kërkimin e aksesit në informacionin mbi pronësinë përfituese të personave juridikë dhe strukturave juridike;

(b) **modele të standardizuara që përdoren nga regjistrat qendrorë për të konfirmuar ose refuzuar një kërkesë** për akses në regjistër ose për akses në informacionin mbi pronësinë përfituese;

(c) **procedura për të lehtësuar njohjen reciproke të interesit legjitim** për akses në informacionin mbi pronësinë përfituese nga regjistrat qendrorë në Shtetet Anëtare të tjera nga ai ku kërkesa për akses është paraqitur dhe pranuar për herë të parë (...);

(d) **procedura për njoftimin reciprok ndërmjet regjistrave qendrorë** mbi revokimin e aksesit në informacionin mbi pronësinë përfituese sipas nenit 13(8).

Për të siguruar kushte të barabarta në zbatimin e rregullave mbi pronësinë përfituese, është thelbësore që formati për paraqitjen e informacionit mbi pronësinë përfituese në regjistrat qendrorë përkatës të harmonizohet në të gjithë Bashkimin Europian. Për më tepër, kërkesat e standardizuara për paraqitjen e këtij informacioni do të forconin transparencën, do të lehtësonin bashkëpunimin ndërkufitar dhe do të garantonin identifikimin e besueshëm të pronarëve përfitues në të gjithë Bashkimin.

<p>Aktet zbatuese për ndërlidhjen e regjistrave</p> <p>Neni 17</p>	
<p>1) Komisioni mund të përcaktojë, me anë të akteve zbatuese, specifikimet teknike dhe procedurat e nevojshme për të mundësuar ndërlidhjen e regjistrave qendrorë të Shteteve Anëtare (...)</p>	<p>//</p>
<p>Ndryshimet në Direktivën (BE) 2015/849</p> <p>Neni 74</p>	
<p>Direktiva (BE) 2015/849 ndryshohet si vijon:</p> <p>1) në nenin 30(5), nënparagrafët e parë dhe të dytë zëvendësohen me tekstin e mëposhtëm:</p> <p>“5. Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që informacioni mbi pronësinë përfituese të jetë i aksesueshëm në të gjitha rastet për:</p> <p>(a) autoritetet kompetente dhe NJIF-et, pa asnjë kufizim;</p> <p>(b) subjektet raportuese, në kuadër të vigjilencës së duhur ndaj klientit në përputhje me Kreun II;</p> <p>(c) çdo person ose organizatë që mund të provojë një interes legjitim.</p> <p>Personave ose organizatave të përmendura në pikën (c) të nënparagrafit të parë u lejohet të kenë akses të paktën në emrin, muajin dhe vitin e lindjes, vendin e banimit dhe shtetësinë e pronarit përfitues, si dhe në natyrën dhe shtrirjen e interesit përfitues të mbajtur.”</p>	<p>Ky ndryshim forcon transparencën e pronësisë përfituese duke siguruar që informacioni mbi pronarët realë pas personave juridikë të mund të aksesohet nga autoritetet kompetente, NJIF-et, subjektet raportuese dhe personat me interes legjitim.</p> <p>E njëjta gjë vlen edhe për informacionin mbi pronësinë përfituese të një trusti ose një strukture juridike të ngjashme (paragrafi 2).</p>



Transparency International EU

31 Rue du Commerce, 1000 Brussels

+32 (0) 4 97 49 90 81

Transparency Register ID: 501222919
71